



REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 25, Datë 28.02.2019

MBI

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “KESH” SH.A NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË  
ENERGJISË ELEKTRIKE.**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2, gërma “ç” dhe nenit 39 pika 3, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, neni 4, pika 1, gërma “d”; neni 5, pika 1, gërma “d”, neni 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, si dhe nenit 15 të “Rregullores për Organizimit Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.06.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 28.02.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për licencimin e shoqërisë “KESH” sh.a, në aktivitetin e Furnizimit të Energjisë Elektrike,

**Kostatoi se:**

- Me Vendimin e Bordit nr. 4, datë 17.01.2019, ERE ka filluar procedurat për licencimin e shoqërisë “KESH” sh.a., në aktivitetin e Furnizimit të Energjisë Elektrike.
- Me shkresat nr. 5/2 Prot., datë 18.01.2019 dhe nr. 5/7 Prot., datë 13.02.2019, ERE i është drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për informacion, lidhur me kërkesën e shoqërisë “KESH” sh.a. për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, nisur nga parashikimi i pikës 3, gërma “b” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.729, datë 08.12.2017.
- Në vijim të kësaj vendimmarrje ERE me shkresën nr. 32/1 Prot., datë 18.01.2019, publikoi në median e shkruar njoftimin për fillimin e kësaj procedure.
- Nuk rezulton të ketë ardhur asnjë koment nga palët.
- Nuk rezulton të ketë ardhur asnjë përgjigje nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në lidhje me këtë kërkim.  
ERE shqyrtoi aplikimin e shoqërisë KESH sh.a. dhe nga sa depozituar në ERE më këtë kërkesë rezulton si më poshtë.

Aplikimi i shoqërisë “KESH” sh.a, plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1 gërmat “a”, “b”, “c”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat (“a”, “b”, “c”, “d”, “e”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionin financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3, gërmat “a”, “b” “c”, “d”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7.1, gërmat “a”, “b”, “c”), është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të licencojë shoqërinë “KESH” sh.a., në aktivitetin e Furnizimit të Energjisë Elektrike, për një afat 5 (pesë) vjeçar, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**

**NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM**  
**ANËTARE E BORDIT**  
**ERJOLA SADUSHI**